

KOMUNA E VITISË 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Vitisë udhëhiqet nga Kryetari Sokol Haliti i cili përfaqëson subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës. Ky është mandati i tij i parë në krye të komunës. Në vitin 2000, Haliti ka qenë këshilltar komunal, ndërsa në vitin 2004 është zgjedhur drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Rreth 88% e qytetarëve të Vitisë konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.¹ Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Haliti 75% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa 53% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.²

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar pesë problemet kryesore të Komunës së Vitisë. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e rrjetit të kanalizimit në shumë vendbanime, prezenca e mbeturinave në shumë pjesë të qytetit, problemet infrastrukturore nëpër shkolla, mungesa e ndriçimit publik, mungesa e tregut të gjelbër si dhe mungesa e tregut të kafshëve.³

¹ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

² UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

³ Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Vitisë 2013. Burim: <http://bit.ly/2wLvO4n> (Qasur me 18.06.2017)

Problemet aktuale të Komunës së Vitisë

Mungesa e rrethojave të objekteve shkollore

Një pjesë e konsiderueshme e objekteve shkollore në Viti nuk kanë rrethoja të vendosura. Kjo është vlerësuar si faktor që po ndikon që në oborret e shkollave të hyjnë persona që po ndikojnë negativisht në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Komuna e Vitisë ka pranuar zyrtarisht 7 shkresa nga qytetarët që kërkojnë vendosjen e rrethojave të tilla. Kërkesat janë bërë nga fshati Zhiti, Fshati i Ri, Terstenik, Stubell e Epërme, Verban dhe nga dy lokalitete brenda qytetit të Vitisë.⁴

Mungesa e ujit të pijes

Ky problem ka qenë në mesin e problemeve të listuara edhe në raportet e publikuara para zgjedhjeve të nëntorit 2013. Komuna e Vitisë përballet me mungesë të ujit të pijshëm, si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra. Madje edhe në ato zona ku është i shtrirë ujësjellësi, sasia e ujit është e pamjaftueshme dhe reduktimet janë mjaft të shpeshta. Disa prej fshatrave që përballen me këtë problem janë fshati Letnicë, Skifter, Smirë, Tërstenikë, Binqë. Edhe shkollat kanë të njëjtin problem, si shkolla fillore "28 nëntori" në fshatin Verban, shkolla fillore e Smirës, ajo e Tërstenikut. Të njëjtin problem e ka edhe Qendra e Mjekësisë Familjare në fshatin Pozheran dhe ajo në Sllatinë. Gjendja qëndron diçka më mirë në qytet, por edhe në qytet ka reduktime të shpeshta të ujit të pijes.

Mungesa e ndriçimit publik

Nga 39 fshatra sa ka Komuna e Vitisë, vetëm në dy fshatra është i shtrirë rrjeti i ndriçimit publik, në 37 fshatra mungon ky rrjet. Me rrjet të ndriçimit publik nuk është i mbuluar as krejt vendbanimet urbane të qytetit. Zyrtarisht në komunë me kërkesë për instalim të rrjetit të ndriçimit publik kanë parashtruar banorët e këtyre lokaliteteve: Zhiti, Remnik, Budrik, Terstenik, lagjaj "Sadovinë e Jerlive", Fshati i Ri, Çiflak, Gushicë, Mjak, Podgorc, Shashare etj.

Mungesa e ngrohjes në shkolla

Një pjesë e konsiderueshme e shkollave në Komunën e Vitisë, veçmas ato nëpër fshatra kanë mungesë të instalimit të ngrohjes. Në shumicën e shkollave hapësira ngrihet me stufa me dru. Në këtë gjendje janë shkollat në fshatrat: Zhiti, Fshat i Ri, Smirë, Godenci i Madh, Vërnez, Kabash, Gërmovë, Ballancë.

⁴ Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të zhvillimeve lokale.

Pastrimi i lumit nga mbeturinat

Edhe përkundër përpjekjeve të autoriteteve komunale në vitet e fundit për t'i pastruar dhe mirëmbajtur shtretërit e lumenjve në Viti, ky problem vazhdon t'i atakoj disa nga fshatrat e kësaj ane, veçmas në Zhiti dhe Radivojë.

Mungesa e fushave të sportit dhe këndeve për fëmijë

Komuna e Vitisë vazhdon të ketë hapësira të pakta për rekreacion, sport, dhe kënde për fëmijë. Janë disa zona të kësaj komune që në gusht të 2017 kanë parashtruar kërkesa në komunë për rregullimin (ndërtimin) e terreneve sportive si lokacioni Fshati i Ri, Verban, Sadovinë e Çerkezëve, Sllatinë, Ramnishtë, Vërnakollë.

Mungesa e rrjetit të kanalizimit

Pjesa më e madhe e fshatrave të komunës së Vitisë nuk kanë rrjet të rregulluar të kanalizimeve. Kjo gjendje shkakton kundërmim të erërave për shkak të gropave të hapura ku derdhen kanalizimet. Gjendja është me e keqe veçmas në lokalitetin e quajtur Fshati i Ri. Pa rrjet të kanalizimit janë edhe fshatrat Verban, Sllatinë e Epërme, Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Radivojcë dhe në fshatin Sadovinë.

Renovimi i ambulancave në fshatra

Banorët e dy fshatrave të Vitisë (Remnik dhe Sllatinë e Epërme) ka dy vite që kërkojnë nga autoritetet komunale renovimin e ambulancave në fshatrat e tyre. Objektet në fjalë janë në gjendje të keqe infrastrukturore, duke përfshirë gjendjen e keqe higjienike, mungesën e dyerve dhe dritareve në disa raste si dhe mungesën e instalimeve të rrymës.

Trendet buxhetore në Komunën e Vitisë (2017)


Komuna e Vitisë në vitin 2017 ka planifikuar 10 milionë euro buxhet.⁵ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 173 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,⁶ ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 130 mijë euro.⁷ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Vitisë ka pasur një rritje të buxhetit për afro 1.7 milionë euro.

⁵ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

⁶ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63


⁷ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArjf>, faqe 60

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Vitisë 2017



Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Vitisë vazhdimisht ka ndarë buxhet më të madh për kategorinë e pagave dhe mëditjeve , përderisa investimet kapitale kanë pasur rënie të vazhdueshme gjatë katër viteve të fundit.

Figura nr.2: Trendët buxhetore në komunën e Vitisë 2013 dhe 2017




Kategoria e pagave dhe mëditjeve ka qenë rreth 5.3 milionë euro në 2013, ndërsa është rreth 7 milionë euro në 2017. Rritja prej pothuajse dy milionësh mund t'i atribuohet vendimit të

kryeministrit në vitin 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%⁸. Edhe pse Vitia ka punësuar vetëm një person më shumë sesa para katër vitesh, kjo komunë karakterizohet me një numër të madh të individëve të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta në 2017, saktësisht 46 sosh.

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Vitia ka pasur rënie për rreth 50 mijë euro duke zvogëluar pjesëmarrjen në buxhetin total për vitin 2017 për pesë pikë përqindjeje nga 22% në 2013 në 17% në vitin 2017. Kategoria e shpenzimeve komunale dhe e mallrave dhe shërbimeve është rritur, por pjesëmarrja në buxhet mbetet me përqindje të njëjtë. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve është rritur për afro 60 mijë euro, por pjesëmarrja në buxhetin total të komunës mbetet e njëjtë sikurse në vitin 2013.


Figura nr.3: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Vitisë gjatë vitit 2016 ka realizuar të hyra në vlerë afër 950 mijë euro. Kjo shumë është dukshëm më e madhe se të hyrat e realizuara në vitin 2013 ku shihet një rritje rreth 290 mijë eurosh të hyra. Kategoria kryesore e të hyrave në Viti është ajo nga tatimi në pronë.

⁸ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

Figura: nr.4: Të hyrat vetanake në Komunën e Vitisë 2013-2016



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat në të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmarr këto veprime:

- Komuna duhet të shoh me prioritet sigurinë e nxënësve dhe të krijojë kushte elementare për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Vendosja e rrethojave në objektet shkollore dhe vendosja e kamerave nuk llogaritet të jetë shumë e kushtueshme.
- Komuna duhet të shtrijë rrjetin e ndriçimit publik në të gjitha zonat e banuara. Me prioritet duhet t'i shoh zonat të cilat tani me kanë parashtruar kërkesa në komunë për këtë qellim.
- Komuna duhet t'i rinovojë ambulancat në fshatin Remnik dhe Sllatinë e Epërme.
- Komuna duhet të zëvendësojë sistemin e ngrohjes nëpër shkolla. Instalimi i ngrohjes qendrore duhet shihet me prioritet.
- Komuna duhet t'i rrisë numrin e hapësirave rekreative/sportive
- Komuna duhet të shtrijë rrjetin e ujësjellësit veçmas në fshatrat me numër të madh banorësh.
- Komuna duhet të ndërmarr masa për të parandaluar hedhjen e mbeturinave në shtri e lumenjve.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world